

VENDIM
Nr. 34, datë 4.3.2019

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË,
KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR
INTEGRIM, QARKU ELBASAN, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA
KUVENDI I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 4.3.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri	Kryetar
Denar Biba	Zv/kryetar
Bledar Skënderi	anëtar
Edlira Jorgaqi	anëtare
Rezarta Bitri	anëtare

Shqyrtoi çështjen me

Objekt: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Elbasan, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Edmond Llazar Haxhinasto.

Kërkues: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Baza ligjore: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Nëpërmjet shkresës nr. 762/2 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit z. Edmond Llazar Haxhinasto, deputet i zonës zgjedhore, Qarku Elbasan.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar partia Lëvizja Socialiste për Integrim për zonën zgjedhore Qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 2 (dy) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Elbasan, është si më poshtë: me numër rendor 1 (një) znj. Monika Ramazan Kryemadhi dhe me numër rendor 2 (dy) z. Edmond Llazar Haxhinasto.

Rezulton se lista shumëmemërore e partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Elbasan, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës.

Gjithashtu, konstatohet se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, fjalë e dytë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës së partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në zonën zgjedhore Qarku Elbasan.

Në bazë të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, Qarku Elbasan, të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për deputet me numër rendor 3 (tre), z. Enver Mersin Roshi.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Z. Enver Mersin Roshi, referuar ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 1.3.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2105.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Enver Mersin Roshi, rezulton se ka deklaruar ndryshim në gjenealitetet në mbiemrin e tij nga Rroshi bëhet Roshi.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 919 prot., datë 1.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 918 prot., datë 1.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për deputet, Qarku Elbasan, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Enver Mersin Roshi, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. V-668/1 prot., datë 1.3.2019 zyra e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, Qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Edmond Abaz Rrush, sipas të cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Enver Mersin Roshi, rezulton se nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës në listën shumemërore të partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në zonën zgjedhore Qarku Elbasan, i renditur me numër rendor 3 (tre), z. Enver Mersin Roshi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a" dhe në nenin 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Elbasan, z. Enver Mersin Roshi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARI
Klement Zguri